



**RAPORTI I PËRGJITHSHËM
I INSPEKTIMEVE
VITI 2013**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
INSPEKTORATI QENDROR

Inspektorati Qendror është institucion publik qendror i cili bashkërendon dhe mbështet veprimtarinë e inspektorateve shtetërore dhe të inspektorateve vendore dhe mbikëqyr zbatimin e ligjit nr. 10433, datë 16.06.2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë” dhe ligjeve të posaçme nga Inspektoratet Shtetërore.

MESAZHI NGA INSPEKTORI I PËRGJITHSHËM

Ky raport i parë i veprimtarive inspektuese në vend, pas miratimit të ligjit, vjen në një kohë kur Qeveria Shqiptare ka mobilizuar të gjitha asetet për të luftuar korrupsionin dhe krijuar një partneritet të denjë me sektorin e biznesit, si dhe reforma e ndërmarrë në inspektime ka hyrë në fazën më të rëndësishme të implementimit të saj. Raporti siguron një përmbledhje të aktiviteteve të këtij Institucioni dhe trupave inspektuese të ministrive të linjës që nga koha kur filloi kjo reformë në vitin 2011 e në vazhdim, veçanërisht aktivitetet e kryera për vitin 2013.

Siç dihet, Qeveria Shqiptare ndërmori Reformën Rregullatore për përmirësimin e klimës së biznesit në vend. Pjesë e kësaj reforme është edhe ajo e inspektimeve e cila synon uljen e barrës administrative për biznesin dhe rritjen e efektivitetit të trupave inspektuese, për të garantuar zbatimin e rregullave dhe konkurrencën e lirë në treg. Në këtë kuadër, u krijua Inspektorati Qendror me mision përmirësimin e efektivitetit dhe përgjegjshmërisë së veprimtarive të inspektimit në Republikën e Shqipërisë.

Nën mbikëqyrjen e Inspektoratit Qendror, aktualisht të gjitha trupat inspektuese ekzistuese në vend janë drejt përfundimit të procesit të riorganizimit në Inspektoratet Shtetërore të cilat do të garantojnë zbatimin e rregullave të detyrueshme në veprimtarinë e përditshme të bizneseve dhe individëve, sipas procedurës së re të inspektimit.

Sfida jonë mbetet lufta kundër korrupsionit për të nxitur një kulturë të zbatimit të rregullave në vendin tonë. Inspektorati Qendror synon instalimin e një qasjeje të re për mënyrën e kryerjes së inspektimeve, që do të ndihmojë në përmirësimin e transparencës dhe llogaridhënies të sistemit të inspektimit në vend dhe në reduktimin e korrupsionit. Megjithatë, lufta kundër korrupsionit, që të ketë sukses, ka nevojë për mbështetje të gjerë nga ana e të gjithë aktorëve të interesuar. Institucioni i Inspektorit të Përgjithshëm mbështetet parimin se nuk ka nëpunës publik, pavarësisht nga rangu apo pozita, që të jetë mbi ligjin.

Ne mund të arrijmë suksese nëse punojmë së bashku, të gjithë aktorët e interesuar, për parandalimin e rasteve të moszbatimit të rregullave, për të rritur besimin e shoqërisë te Qeveria

Shqiptare. Raporti tregon përkushtimin e institucionit tonë për të përmbushur misionin në ruajtje të integritetit të Qeverisë Shqiptare dhe rritjen e besimit të publikut te institucionet.

Ilir ZELA

PËRMBAJTJA

MESAZHI I INSPEKTORIT TË PËRGJITHSHËM

- I. PËRMBLEDHJE**
- II. HYRJE**
 - Qëllimi
 - Objektivat
 - Metodologjia
- III. REFORMA NË SISTEMIN E INSPEKTIMIT**
 - a. Ndërmarrja e reformës në inspektime, finalizimi dhe monitorimi i zbatimit të saj**
 - 1. Ligjore
 - 2. Institucionale
 - 3. Përmbajtësore. Modernizimi teknik dhe teknologjik
 - 4. Financiare
 - b. Reforma në inspektime dhe integrimi në BE**
- VI. RAPORTIMI I VEPRIMTARISË SË TRUPAVE INSPEKTUESE SIPAS MINISTRIVE TË LINJËS. REZULTATET E SHQYRTIMIT.**
 - 1) Ministria e Punëve të Brendëshme
 - 2) Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës
 - 3) Ministria e Zhvillimit Urban dhe Turizmit
 - 4) Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Tregëtisë dhe Sipërmarrjes
 - 5) Ministria e Arsimit dhe Sportit
 - 6) Ministria e Kulturës
 - 7) Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë
 - 8) Ministria e Shëndetësisë
 - 9) Ministria e Energjisë dhe Industrisë
 - 10) Ministria e Mjedisit
 - 11) Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave
- V. KOMENTE**
- VI. PRAKTIKAT E MIRA**
- VII. REKOMANDIME**
- VIII. KONKLUZIONE**
- IX. ANEKSE**
 - ANEKSI I :** Lista e akteve nënligjore të miratuara
 - ANEKSI II:** VKM për krijimin e Inspektorateve shtetërore
 - ANEKSI III:** Draft aktet nënligjore për miratim

I. PËRMBLEDHJE

Reforma e inspektimeve, me të dy qëllimet e saj i) rritjen e efektivitetit të trupave inspektuese në parandalimin e risqeve ii) uljen e barrës administrative dhe kostove mbi veprimtarinë e biznesit, si dhe të gjithë komponentët përbërës të saj, ligjor, riorganizues, programues e metodologjik dhe procedural, është një nga fushat me thelbësore të reformës së drejtës administrative dhe të përmirësimit të mjedisit rregullator. Prandaj modeli i ri i inspektimeve që sjell ligji përmban parime, rregulla organizative dhe procedura inspektuese që synojnë arritjen e njëkohshme të këtyre dy qëllimeve.

Reforma e inspektimeve përfshin edhe fuqizimin me teknologji informacioni të trupave inspektuese nëpërmjet ngritjes së një portali unik të sistemit të inspektimeve “e-inspektimi”, i cili menaxhohet nga Inspektorati Qendror, si një instrument monitorimi e koordinimi të veprimtarisë së inspektorateve shtetërore, si dhe të informimit të publikut. Ky portal është pjesë e programit e-qeverisjes të Qeverisë Shqiptare dhe synon krijimin e regjistrat elektronik të akteve inspektuese si pjesë e bashkësisë së regjistrave elektronike në vend.

Raporti mbi veprimtarinë e inspektimit në Republikën e Shqipërisë deri në vitin 2013, që po ju paraqesim, përfshin gjetjet në veprimtarinë e trupave inspektuese sipas ministrive të linjës, praktikave e mira, konkluzione, si dhe rekomandime lidhur me përmirësimin e performancës së tyre në të ardhmen. Ky raport synon, midis të tjerash, adresimin e problematikës së situatës në të cilën gjendemi ku kryhen një numër shumë i madh inspektimesh, pa metodologji dhe mungesë transparence, e cila pritet të ndryshojë me forcimin e mbikëqyrjes dhe koordinimit të veprimtarisë inspektuese nga ana e Inspektoratit Qendror, ushtrimin e kompetencave të këtij të fundit për kontrollin e brendshëm të të gjithë Inspektorateve Shtetërore në vend dhe aksesin në raportet e tyre të inspektimeve, ankimeve, këshillimeve për programet e tyre vjetore, shqyrtimi i raportimeve dhe menaxhimin e procesit të trajnimit dhe certifikimit të inspektorëve.

Aktualisht reforma është në një fazë të rëndësishme të zbatimit të saj, ku tre Inspektorate shtetërore janë përzgjedhur për të filluar zbatimin e procedurave të reja të inspektimit, përkatësisht i punës, shëndetësisë dhe mjedisit. ISHPSHSH ka plotësuar dokumentacionin unik dhe po punon intensivisht për hedhjen e të dhënave në portal për të filluar shumë shpejt inspektimet online.

Të gjitha këto synojnë krijimin e një sistemi modern inspektimesh në linjë me praktikave më të mira të Bashkimit Evropian, eliminimin e barrës së panevojshme administrative për biznesin për të bërë të mundur kontributin sa më të madh të tij në rritjen ekonomike të vendit nëpërmjet reduktimit të masës së informalitetit të ekonomisë, si dhe përmirësimi i luftës kundër korrupsionit.

II. HYRJE

Ky Raport do të analizojë arritjet e deritanishme dhe do të udhëzojë përfundimin e reformës së sistemit të inspektimit në Shqipëri.

Qëllimi

Raporti synon të japë një vlerësim objektiv për arritjet e reformës së inspektimeve në vendin tonë deri në vitin 2013, një panoramë të plotë të aktivitetit të kryer nga trupat inspektuese nga viti 2011 deri në momentin aktual, analizë e veprimtarisë e ISH me pikat e dobëta dhe të forta të tyre, si dhe rekomandimet e nevojshme për të bërë përmirësime në të ardhmen.

Në këtë mënyrë të gjithë aktorët e interesuar gjejnë arritjet në drejtim të reformës e mbahen të informuar dhe kjo rrit transparencën ndaj bizneseve dhe publikut të gjerë.

Objektivat

1. Të evidentojë veprimtarinë e të gjitha inspektorateve shtetërore që përfshihen në fushën e veprimit të ligji nr. 10433, datë 16.06.2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, nga viti 2011 e në vazhdim.
2. Paraqitja e këtij raporti për njohje Këshillit të Ministrave, sipas detyrimeve të ligjit të sipërpërmendur.
3. Të njoftojë Inspektoratet Shtetërore për nevojën për të bërë ndryshimet e duhura dhe në kohë për të rritur performancën në inspektime, si dhe ndërgjegjësimin e publikut.
4. Të vendosë rregulla dhe standarde të përgjithshme të raportimit të Inspektorateve Shtetërore sipas detyrimeve të ligjit të sipërpërmendur

Metodologjia

Për të përmbushur qëllimin dhe objektivat e mësipërm, u bënë analiza dhe vlerësime të dokumenteve strategjike të inspektimit, legjislacionit dhe gjetjeve në terren, si më poshtë:

- U ndoqën parimet e ligjit 10433 datë 16.06.2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë” dhe ligjet sektorale, si dhe VKM, udhëzime, urdhra e rregullore të nxjerra nga Inspektorati qendror dhe Inspektoratet shtetërore.
- Raportet vjetore të hartuara nga inspektoratet shtetërore për vitin 2013, për fushat përkatëse të inspektimit që ato mbulojnë.
- Gjetjet e konsulentëve të projektit BERIS në lidhje me hapat e ndërmarra për zbatimin e reformës së inspektimeve në vendin tonë. Progres raportet e BE.
- Gjetjet e IQ gjatë procesit të inventarizimit të inspektorateve e të riorganizimit të tyre, amendimet e ligjeve sektoriale për pjesën e procedurës së inspektimit dhe inspektimeve e kryera në ISH përkatëse gjatë vitit 2013.

III. REFORMA NË SISTEMIN E INSPEKTIMIT

a. Ndërmarrja e reformës në inspektime, finalizimi dhe monitorimi i zbatimit të saj.

Reforma rregullatore e ndërmarrë nga Qeveria shqiptare për përmirësimin e klimës së biznesit në vendin tonë, ka si një ndër pjesët më të rëndësishme të vet reformën e inspektimeve me komponentët përbërës të saj që përfshin atë legjislativë, strukturore, të përmbajtjes e të modernizimit teknologjik dhe të financimit.

- *Pikënisja dhe thelbi i reformës në inspektime*

Qeveria Shqiptare ndërmori reformën e inspektimit në vitin 2008 në sajë të bashkëpunimit të saj me Bankën Botërore, pas paraqitjes së raportit ARCS nga FIAS në vitin 2005 dhe të studimit në kuadër të Projektit të tyre të përbashkët "BERIS"¹. Në këtë raport u dhanë vlerësimet e para lidhur me efektivitetin e ulët të inspektimeve dhe kostot e barrierat e dëmshme të shkaktuara prej tij mbi veprimtarinë ekonomike dhe jo-ekonomike. Ky raport u pasua nga një inventar i imët i trupave inspektuese dhe legjislacionit përkatës në Shqipëri deri në prill 2008, ku doli që bizneset inspektoheshin mesatarisht 13.8 herë brenda një viti nga 14 inspektorate të ndryshme, inspektorët shpenzonin mesatarisht 45 ditë pune pranë çdo biznesi. Kostoja e inspektimeve mbi bizneset ishte tejet e lartë në total afërsisht 5.3 milion ditë pune në shërbim të inspektimeve që kryheshin mbi to, duke përbërë kështu një barrë të rëndë. Gjithashtu trupat inspektuese, në tërësinë e tyre ishin të fragmentuara, të pakoordinuara, me mungesa në rregullore dhe udhëzime të detajuara e të qarta dhe me mangësi lidhur me metodat moderne të inspektimeve.

Si konkluzion i studimit të kryer, sistemi i inspektimit në Shqipëri, ndërsa kishte mangësi të theksuara në arritjen e qëllimit të parandalimit të risqeve dhe ndëshkimin e shkeljeve të rregullave, krijonin një kosto shtesë të padobishme mbi veprimtarinë e bizneseve. Bazuar në këto përfundime, u ndërmor një reformë e thellë e inspektimeve për të mundësuar arritjen e njëkohshme të dy qëllimeve bazë: rritjen e efektivitetit të trupave inspektuese në parandalimin e risqeve, uljen e barrës administrative dhe kostove mbi veprimtarinë e biznesit.

Reforma përfshin katër komponentë të adresuar, si më poshtë:

1. *Komponenti legjislativ:*

Miratimi nga Parlamenti Shqiptar i ligjit nr. 10433, datë 16.06.2011 "Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë", si dhe hartimi e miratimi nga Këshilli i Ministrave i paketës së akteve nënligjore, si dhe Urdhrave të Kryeministrit.²

Ligji nr. 10433, datë 16.06.2011 "Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë" parashikon unifikimin e rregullave për organizimin e trupave me funksione inspektimit dhe të procedurës

¹ Reform of the Inspection System in Albania. Preliminary Impact Assessment. "Business Environment Reform and Institutional Strengthening" (BERIS). Tirana, 4 December 2009. In the framework of the World Bank Project ID No. P096643.

² E gjithë paketa e aktave nënligjore e miratuar e reformës së inspektimit gjendet në Aneksin nr.1

administrative të inspektimit. Ndër risitë kryesore që sjell ky ligj janë: procedura unike inspektimi, vlerësimi mbi bazë risku, trajnimi dhe certifikimi, tregues performance, trupa kompakte inspektimi, portal unik e-inspektimi, rritje të rolit të inspektorit në procesin e inspektimit dhe të përgjegjshmërisë në detyrë të tij, si dhe rritja e aftësisë parandaluese, zhvillimi inspektive të përbashkëta të disa Inspektorateve shtetërore nën drejtimin dhe koordinimin e IQ.

Harmonizimi i legjislacionit sektorial me ligjin e inspektimit.

Legjislacioni sektorial i zhvilluar në më shumë se 20 vite të ekonomisë së tregut kishte krijuar një sistem shumëllojësh inspektimesh, procedurash, metodologjish, masa dënimesh, që të gjitha së bashku shkaktonin një mjedis të komplikuar normativ me efekte negative të dyfishtë, si në uljen e efektivitetit të inspektiveve ashtu edhe në rritjen e kostove dhe risqeve të padobishme mbi veprimtarinë ekonomike.

Ligji i inspektimit krijoi një bazë shumë të plotë ligjore që i jep zgjidhje çështjeve organizative, procedurale e metodologjike, për të gjitha llojet e inspektiveve, duke unifikuar çështjet që i përkasin procedurës së inspektimit. Prandaj, ndërhyrjet amenduese në legjislacionin sektorial përfshinë mbi 77 ligje sektoriale, por të kufizuar vetëm për çështje që lidhen me inspektimin, pra nuk prekën parimet dhe normat bazë që përcaktohen nga legjislacioni sektorial.

2. Komponenti organizativ

Krijimi dhe funksionimi i Inspektoratit Qendror

Në bazë të nenit 15 të ligjit nr. 10433, datë 16.06.2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë” u krijua Inspektorati Qendror, i cili funksionon dhe sipas Vendimit nr. 630, datë 14.09.2011 “Për organizimin dhe funksionimin e Inspektoratit Qendror”, i ndryshuar, të Këshillit të Ministrave, me strukturë sipas Urdhrit të Kryeministrit nr. 5, datë 31 Janar 2013. Inspektorati Qendror u krijua si institucion publik qendror në varësi të Kryeministrit. Misioni kryesor i Inspektoratit Qendror është përmirësimi i efektivitetit dhe përgjegjshmërisë së veprimtarive të inspektimit në Republikën e Shqipërisë.

Inspektorati Qendror përbëhet prej Drejtorisë së Udhëheqjes Metodologjike dhe Koordinimit dhe Drejtorisë së Mbikëqyrjes dhe e-Inspektimit dhe ka një staf prej 15 punonjësish. Funksionet më sipër janë rregulluar në detaje me VKM nr. ë, datë 16 Gusht 2013 “Për procedurat e hollësishme për ushtrimin e kompetencave të Inspektoratit Qendror dhe rregullat për përmbajtjen dhe administrimin e portalit unik të inspektimit”.

Në përmbushje të detyrave të saj Inspektoratit Qendror ka kryer gjatë muajve shtator-dhjetor 2012 dy misione inspektimi, përkatësisht në Autoritetin Shëndetësor Rajonal, Tiranë dhe Inspektoratin e Punës, Shkodër, me qëllim mbikëqyrjen e zbatimit të ligjit 10433, datë 16.06.2011 "Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë", si dhe të ligjeve të tyre të posaçme. Analiza u krye nëpërmjet shqyrtimit të dokumentacionit të marrë pranë këtyre dy institucioneve, për të cilat janë përgatitur raportet dhe rekomandimet përkatëse të përfshira edhe në këtë raport.

Gjithashtu, gjatë vitit 2013 Inspektoratit Qendror ka zhvilluar disa aktivitete në kuadër të Marrëveshjes së Mirëkuptimit ndërmjet Projektit Rritje Albania dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Patentave dhe Markave Tregtare me titull "Mbrotjtja e Pronësisë Intelektuale dhe Reforma në

Inspektim”, me qëllim organizimin në muajt Prill-Qershor 2013 të disa tryezave të rrumbullakëta me pjesëmarrjen e kompanive të interesuara në rrethet Tiranë, Fier, Shkodër, Korçë, Durrës.

Në bashkëpunim me OSBE, Inspektorati Qendror po harton Kodin Etik dhe të Sjelljes së inspektorëve shtetërorë, që pritej të finalizohet në muajt Nëntor-Dhjetor 2013 (është shtyrë), për implementimin e së cilës nga inspektoratet shtetërore ka disa opsione.

Riorganizimi i trupave të reja inspektuese në Inspektorate shtetërore

Në vitin 2013, nën drejtimin e Task Forcës dhe Inspektoratit Qendror, vetë ministritë analizuan organizimin ekzistues të trupave inspektuese dhe propozuan zgjidhjet e përshtatshme për ngritjen e secilit prej Inspektorateve shtetërore në varësi të ministrisë përkatëse. Për secilën ministri u hartuan draft aktet nënligjore që përcaktojnë inspektoratet që do të bashkoheshin në një inspektorat të vetëm shtetëror, si dhe organigramat e rregullat bazë të funksionimit të secilit Inspektorat shtetëror.

Në riorganizimin e trupave inspektuese u përfshinë shtatë ministri ku në secilën prej tyre krijohen Inspektoratet shtetërore unike sipas parimit një inspektorat një ministri³:

1. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit, MBUMK
2. Inspektorati Shtetëror i Mbikëqyrjes së Tregut, METE⁴
3. Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore, MPCSSB
4. Inspektorati Shtetëror i Arsimit, MAS⁵
5. Inspektorati Shtetëror i Trashëgimisë Kulturore dhe Turizmit, MTKRS⁶
6. Inspektorati Shtetëror Shëndetësor, MSH
7. Inspektorati Shtetëror i Mjedisit, Pyjeve, Ujërave dhe Peshkimit, MMPAU.

Krijimi i shtatë inspektorateve në shtatë ministritë e mësipërme do të reduktonte numrin e inspektorateve dhe trupave inspektuese aktuale nga 28 në 7 dhe në tërësi nga 36 trupa inspektuese aktualisht në 12 të tilla.

3. Komponenti përmbajtësor. Modernizimi teknik dhe teknologjik

Përgatitja e metodologjive të reja të inspektimit në përputhje me ligjin e ri

Reforma e inspektimit konsiston në metodologji dhe procedura të reja inspektuese. Parimi bazë i metodologjisë së re është se programet e inspektimit do të jenë rrjedhojë e analizës sektoriale të riskut. Sipas kësaj metodologjie synohet që përmes numrit minimal të inspektimeve të arrihet efekti maksimal parandalues dhe garantues i niveleve të synuara të sigurive përkatëse publike (shëndetësore, ushqimore, të tregut, të konsumatorit, të punës, mjedisit etj). Për këtë qëllim

³ Aneksi II i akteve nënligjore për krijimin e Inspektorateve shtetërore.

⁴ Me VKM në 30 shtator 2013 është shfuqizuar VKM Nr. Dt për krijimin dhe funksionimin e Inspektoratit Shtetëror të Mbikëqyrjes së Tregut në. Pasi funksionet e saj të Inspektimit tani bien në fushën e veprimtarisë së dy ministrive të ndryshme, MZhETS dhe MEI.

⁵ Të rishikohet VKM për përfshirjen këtu të funksioneve të inspektimit në fushën e sporteve, të kaluar rishtas në MAS.

⁶ VKM-ja për krijimin dhe funksionimin e këtij institucioni mbeti në draft pasi funksionet e inspektimit të këtij inspektorati tani do të bienin në fushën e veprimtarisë së dy ministrive të ndryshme, MZhUT dhe Ministrisë së Kulturës.

INSQ po përgatit udhëzues dhe manuale pune për mënyrën e vlerësimit të riskut, hartimit të programeve periodike të inspektimeve, mënyrës së përzgjedhjes së rastësishme të subjekteve që do të inspektohen, metodologjive të kryerjes së proceseve inspektuese, të përpilimit të procesverbaleve për vlerësimin e respektimit të rregullave të detyrueshme në formën e kërkesave ligjore në çdo fushë e sektor që inspektohet e deri tek mënyra e marrjes së mostrave në fusha të caktuara kur përdoren analiza laboratorike.

Metodologjitë bazë të inspektimit në zbatim të Ligjit për Inspektimin janë tashmë në formë drafti dhe priten konsultimet me Ministrinë e Linjës dhe inspektoratet shtetërore përkatëse për implementimin e metodologjive specifike sektoriale.⁷

Futja e metodave moderne të inspektimit nëpërmjet portalit e-inspektimi

Veprimtaria e përditshme e inspektorateve shtetërore dhe e inspektorëve do të gjejë pasqyrim të plotë në portalin unik e-inspektimi⁸. Synimi final i këtij portali është që proceset dhe aktet e dokumentimit të procedurës së inspektimit të jenë tërësisht në format elektronik dhe të aksesueshme në kohë reale. Përdorimi i teknologjisë së komunikimit dhe informimit do të zgjerohet shkallë shkallë deri kur sistemi të maksimizojë transparencën për publikun, të lehtësojë koordinimin horizontal mes inspektorateve shtetërore, si dhe drejtimin e proceseve inspektuese nga Inspektorati Qendror e monitorimi prej këtij të fundit të veprimtarisë së inspektorateve shtetërore. Portali e-Inspektimi konsiderohet si një ndër elementet kryesore për një qeverisje të hapur dhe transparente. Portali do të komunikojë lirshëm me regjistrat e tjerë elektronikë në funksionim, si ai i regjistrimit të bizneseve në QKR, ai i liçencave dhe lejeve në QKL, e formalizuar kjo me marrëveshjen dypalëshe ndërmjet institucioneve respektive.

Si pjesë e funksionimit të këtij portali dhe për të siguruar një platformë të vetme dhe të integruar, në Shkurt 2013, Inspektorati Qendror nënshkroi me USAID marrëveshjen e partneritetit me rimbursim të shumës fikse në mbështetje të sistemit “e-Inspection”. Me anë të kësaj marrëveshjeje, USAID-i i ofrojë Inspektoriatit Qendror 260 paketa portabël të Inspektimit, që përbëhen nga kompjutera laptop dhe nga skanera e printera portabël dhe një lidhje interneti nëpërmjet përdorimit me USB. Kjo paketë është thelbësore për aksesimin në portal dhe kryerjen e inspektimeve në kohë reale në terren, duke bërë çdo inspektim të gjurmueshëm dhe rezultatet e konstatimeve të patjetërsueshme, për eliminuar përfundimisht procesverbale dhe akte administrative jo koherente. Në kuadër të këtij projekti janë trajnuar 260 inspektorë shtetërorë të punës, të shëndetësise, të mjedisit dhe të Zyrës së të Drejtave të Autorit, të cilët janë pajisur me këto paketa portabël nga Inspektorati Qendror.

Inspektorati Qendror ka krijuar Regjistrin Elektronik Kombëtar të Inspektorëve shtetërorë, i cili përditësohet nga ky institucion dhe mund të konsultohen online në faqen zyrtare të Inspektoratit Qendror.⁹

Prioritet është hedhja e të dhënave specifike sektoriale nga përdoruesit (Ministrinë e Linjës dhe Inspektoratet shtetërore) në portalin e-Inspektimi dhe përdorimi i këtij portali nga të gjithë Inspektoratet shtetërore. Për këtë është e domosdoshme angazhimi i zyrave juridike, të personelit dhe të teknologjisë së informacionit të Inspektorateve shtetërore përkatëse.

⁷ Aneks III me draft aktet nënligjore të përgatitura nga Inspektorati Qendror.

⁸ Portali unik e-inspektimi funksionon sipas VKM nr. 696, datë 16.8.2013.

⁹ Faqe zyrtare e Inspektoratit Qendrorë ëëë.inspektoratigendror.gov.al

4. Komponenti financiar

Efektet financiare të kësaj reforme kanë rezultuar me financim neto buxhetor më të ulët, pasi riorganizimi i të gjitha trupave inspektuese solli jo rritje të personelit, por ndoshta edhe pakësim të tij, si dhe efekte të uljes së kostove lidhur me shpenzimet operative të tyre për të njëjtën njësi produkti, pasi shërbimet mbështetëse dhe operative përqendrohen në më pak njësi organizative krahasuar me gjendjen e mëparshme.

Për më tepër, procedurat e reja inspektuese, rritja e shkallës së efekteve të programimit të inspektimeve bazuar në vlerësimin e riskut do të çojnë drejt një numri më të vogël, por më të efektshëm inspektimesh, që ul koston totale për inspektimet krahasuar me kostot para saj.

Reforma e inspektimeve përfshin fuqizimi me teknikë e teknologji informacioni të trupave inspektuese dhe kjo do të kërkojë kohë dhe fonde buxhetore dhe të partnerëve ndërkombëtarë.

b. REFORMA E INSPEKTIMIT NE RAPORT ME PROCESIN E INTEGRIMIT NË BE

Në legjislacionin e Bashkimit Evropian nuk ka një direktivë të mirëfilltë evropiane për inspektimin, por modelet me të arrira evropiane të reformave të inspektimit janë baza ku është mbështetur përzgjedhja e modelit shqiptar të kësaj reforme. Modeli Evropian i Mbikëqyrjes së Tregut, e cila mbulon një masë të madhe të produkteve, ka shërbyer si një nga orientuesit e reformës së inspektimeve. Parimet e analizës së riskut, roli këshillues i inspektorateve, planifikimi i inspektimeve drejt sektorëve me risk më të lartë janë pjesë e Direktivës (EC) nr. 765/2008 të cilat janë adaptuar qartësisht në ligjin shqiptar të inspektimit.

Në progres raportin e viti 2013 për Shqipërinë thuhet se Zbatimi i Ligjit mbi inspektimet ka përparuar me miratimin, në shkurt, të dispozitave që synojnë zvogëlimin e kohëzgjatjes dhe koston së inspektimeve. Gjithashtu, është miratuar legjislacioni dytësor për strukturën, organizimin dhe kodin e etikës së personelit të Inspektoratit të Përgjithshëm. Numri i inspektorateve u zvogëlua nga 36 në 11.¹⁰

Në këtë progres raport vihet në dukje se janë miratuar aktet nënligjore të Ligjit për Inspektimet dhe të Ligjit për Inspektoratin e Mbikëqyrjes së Tregut. Janë hartuar procedurat standarde të punës për mbikëqyrjen e tregut për zbatimin e ligjit për sigurinë e përgjithshme të produkteve joushqimore, por **inspektorati i Mbikëqyrjes së Tregut** ende nuk është funksional.

Kapacitetet e vlerësimit të riskut për sigurinë ushqimore ende nuk janë ngritur, kuadri organizativ dhe administrativ i sistemit të inspektimit nuk ka procedura dhe plane inspektimi të përshtatshme, përfshi ato për kontrollin e importeve ushqimore.

Sugjerohet që kapacitetet e sistemit të inspektimit duhet të forcohen dhe duhet të miratohen plane inspektimi sistematik e të krijohen kapacitetet e vlerësimit të riskut. Në fushën e peshkimi nevojiten të forcohen kapacitetet e inspektimit.

¹⁰ Kapitulli Kriteri Politik, Administrata Publike, Progres raporti 2013 për Shqipërinë. Bruksel, më 16.10.2013 SËD (2013) 414.

Inspektimet në institucionet e arsimit të lartë dhe inspektimet nga Inspektorati Kombëtar i Arsimit Parauniversitar në kopshte dhe shkolla fillore e të mesme kanë vazhduar.

Mbrojtja e konsumatorit dhe shëndetit, në fushën e **sigurisë së produkteve**, në mars u ndryshuan disa ligje me qëllim përafrimin e legjislacionit me dispozitat e reja të Ligjit për Inspektimet, përfshi dispozitat për sigurinë e produkteve joushqimore, tregtimin, mbikëqyrjen e tregut dhe metrologjinë. Janë përgatitur akte nënligjore që rregullojnë organizimin e Inspektoratit. Ende nuk është krijuar inspektorati i tregut. Në fushën e **kontrollit të duhanit** Inspektorati Shtetëror i Higjienës vijoi të kryejë inspektime në vend, por ndalimi i duhanit në mjediset dhe institucionet publike nuk respektohet.

IV. RAPORTIMI I VEPRIMTARISË SË TRUPAVE INSPEKTUESE SIPAS MINISTRIVE TË LINJËS. REZULTATET E SHQYRTIMIT.

1) Ministria e Punëve të Brendshme

Policia e mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimit (PMNZSH), nuk ka paraqitur raport vjetor për vitin 2013. I kërkohet të përmbushë detyrimin ligjor të raportimit të INSQ, sipas ligjit të inspektimit dhe VKM përkatëse¹¹.

2) Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës

Inspektorati Ndërtimor Urbanistik Kombëtar (INUK), nuk ka paraqitur raport vjetor për vitin 2013. I kërkohet të përmbushë detyrimin ligjor të raportimit të INSQ, sipas ligjit të inspektimit dhe VKM përkatëse.

3) Ministria e Zhvillimit Urban dhe Turizmit

Nuk ka paraqitur raport vjetor për vitin 2013. I kërkohet të përmbushë detyrimin ligjor të raportimit të INSQ, sipas ligjit të inspektimit dhe VKM përkatëse.

4) Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes

Inspektorati Qendror Teknik (IQT), zhvillon aktivitetin e vet sipas ligjit nr. 9595, datë 27.07.2006 “Për krijimin e Inspektoratit Qendror Teknik” dhe ligje të tjera specifike, si dhe përfshin këto fusha inspektimi: 1. Inspektimin e pajisjeve dhe instalimeve elektrike 2. Inspektimi i naftës e gazit dhe 3. Inspektimin e pajisjeve nën presion.

Gjatë vitit 2013 veprimtaria në këto fusha inspektimi rezulton si më poshtë:

¹¹ Neni 16, pika e) e ligjit 10433, datë 16.06.2011 “Për inspektimin në RSH” dhe Seksioni IX, pika 3 e VKM nr. 696, datë 16.8.2013 “Për përcaktimin e procedurave të ushtrimit të kompetencave të Inspektoratit Qendror dhe të rregullave për përmbajtjen dhe administrimin e portalit “e-inspektimi”.

- Inspektimi i pajisjeve dhe instalimeve elektrike që kryhet nga Drejtoria e Inspektimit të Pajisjeve dhe Instalimeve Elektrike, DIPIE, për mbikëqyrjen e sigurisë elektrike, e cila përfshin kryesisht përmirësimin e sistemit të menaxhimit të sigurisë në faktorët përbërës të tij si: sigurisë së punës së impianteve, pajisjeve dhe instalimeve elektrike; përmirësim i procedurave të punës dhe të punimeve riparuese dhe rritje të shkallës së njohurive tekniko-profesionale të punonjësve që mirëmbajnë impiante, pajisje dhe instalimeve elektrike.

Në bazë të programit vjetor të punës, DIPIE ka kryer 540 kontrolle teknike sipas rëndësisë së pjesës së rrjetit që kontrollohet, nivelit të tensionit, rrezikshmërisë që paraqet, afateve të kontrollit etj. Pjesën më të rëndësishme të kontrolleve teknike e zë kontrolli i tregut, i cili do të vijë duke marrë peshë gjithnjë edhe më të madhe. Nisur nga konstatimet në këto kontrolle, IQT ka bërë propozime në MZHETS për ndërhyrje për përmirësimin e rregulloreve dhe kushteve teknike të projektimit për përmirësimin e skemave të instalimeve të brendëshme elektrike nëpërmjet futjes në përdorim të automateve termodiferencial (salva vita). DIPIE ka vazhduar bashkëpunimin me strukturat e CEZ sh.a. dhe Albtelecom sh.a. lidhur me masat parandaluese që duhet të ndërmarrin për të rritur sigurinë elektrike të rrjeteve elektrike që ato menaxhojnë.

Në këtë periudhë, edhe pse në rënie në krahasim me periudhën paraardhëse, kanë ndodhur 20 aksidente nga të cilat 17 me pasojë vdekje dhe 3 me plagosje. Nga këto 5 raste (3 me vdekje dhe 2 me plagosje) janë të elektricistëve, ku shkaku i aksidenteve është kryerja e procesit të punës pa marrë masat e domosdoshme tekniko-organizative të parrezikshmërisë. Ndërsa rastet e tjera janë aksidente të qytetarëve, si pasojë e ndërhyrjeve abuzive në pajisje, impiante dhe instalime elektrike, në kushtet e mosnjohjes së rrezikut elektrik që ka sjellë rënien nën tension elektrik, apo gjatë instalimit të tubacionit të pompave të ujit duke prekur linja e tensionit 10KV megjithëse ato kanë qenë në përputhje me normat teknike. Nga ana e kësaj trupe inspektuese, për trajtimin e aksidenteve, është vepruar sipas një procedure shumëvjeçare duke përgatitur dosje të ekspertimit teknik me masat administrative përkatëse sipas përgjegjësisë (gjobë, propozim për largim nga puna ose ndjekje penale) dhe marrjen e masave parandaluese.

DIPIE, në vitin 2013, realizuar marrjen në provim të 4482 punonjësve të personelit elektrik, me komisione të autorizuara të veçanta për KESH dhe subjekte të tjera private e publike.

- Inspektimi i naftës e gazit kryhet nga Drejtoria e Inspektimit të Naftës dhe të Gazit (DING) monitoron respektimin e standardeve të cilësisë së naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre nga subjekte të tregtimit me shumicë e pakicë para zhdoganimit, në impiantet e prodhimit dhe instalimet e tregtimit për të shmangur abuzimet dhe falsifikimet. Në bazë të programit vjetor të punës DING ka kryer:

- 1436 inspektime të subjekteve të tregtimit me shumicë apo pakicë të karburanteve dhe lëndëve djegëse, nga të cilat 2281 kontrolle kanë qenë sondazhe rutinë dhe 600 kontrolle para zhdoganimit në doganat hyrëse. Gjatë këtyre kontrolleve janë marrë gjithsej 2821 mostra, nga të cilat ka rezultuar 153 raste me thyerje të treguesve të standardit, për të cilat janë vendosur Akt-Konstatime me propozime për gjobë.


- 821 inspektime për respektimin e normave dhe kushteve teknike në instalime teknologjike të tregtimit të naftës, gazit e nënprodukteve të tyre, ku kanë konstatuar subjekte me shkelje të normave dhe kushteve teknike ose mangësi në dokumentacionin e nevojshëm tekniko-ligjor, për të cilat janë vendosur 158 Akt-Konstatime dhe propozime për pezullimin e kejes së tregtimit për 34 sh. A.

- 85 inspektime të subjekteve që ushtrojnë veprimtarinë e tregtimit të bombolave me GLN. Në këto inspektime është konstatuar se ka shkelje pasi kryenin procesin e tranvazimit nga një bombol në tjetrën, stacione të tregtimit me pakicë të karburanteve që kryenin mbushje të bombolave nga autogazet, dyqane me produkte ushqimore që tregtonin bombola të mbushura, qarkullim në treg të bombolave të pakolauduara e pa emblemën identifikuese të subjektit që i ka mbushur. Për këto shkelje janë bllokuar 32 subjekte me Akt Ndalese, janë zmontuar e më pas sekuestruar 22 pajisje, si dhe sekuestruar 154 bombola të pakolauduara që përbënin rezik për përdoruesit. Janë vendosur gjithsej 25 Akt-Konstatime me gjobë.

Për sa më sipër, IQT ka propozuar e një task force të përbashkët me pjesëmarrjen e pushtetit vendor, policisë së shtetit dhe mbrojtjes nga zjarri, i cili në bazë të të dhënave që disponon ky institucion për numrin dhe vendndodhjen e kryerjes së veprimtarive informale të bëhet heqja e depozitave dhe sekuestrimi i mjeteve. Këtu duhet theksuar se mungon infrastruktura e nevojshme për të kryer me efikasitet sekuestrimin e produkteve, për të cilën duhet të merren masa për pajisjen me autobote për evadimin e mallit të sekuestruar dhe vendmagazinimeve përkatëse.

- Inspektimin e pajisjeve nën presion kryhet nga Drejtoria e Inspektimit të Pajisjeve nën Presion (DIPNP), e cila bën evidentimin dhe inventarizimin e pajisjeve nën presion, inspektimin e subjekteve dhe pajisjeve nën presion për respektimin e kërkesave ligjore dhe rregullave teknike në fuqi për futjen në treg të pajisjeve nën presion, si dhe kryerjen e inspektimit teknik periodik të detyrueshme për pajisjet nën presion nëpërmjet Trupave Inspektuese Palë e Tretë apo Organeve të Vlerësimit të Konformitetit.

Gjatë vitit 2013 janë kontrolluar në subjekte 1603 Deklarata Konformiteti, përkatësisht 1326 kontrolle teknike të enëve nën presion stacionare, 88 kontrolle teknike të kaldajave dhe 189 certifikata Model 013 për autoçisternat që transportojnë mallra të rrezikshme. Gjatë këtyre kontrolleve janë marrë mostra sipas: 1609 në dogana, 221 në tregun e brendshëm dhe 134 për të tretë.




5) Ministria e Arsimit dhe Sportit

Inspektorati Shtetëror i Arsimit (ISHA), gjatë vitit 2013 ka zhvilluar veprimtarinë e tij duke u mbështetur në planin vjetor, si dhe në prioritetet e MAS-it për inspektimin e maturës Shtetërore, provimet e lirisimit, Alterteksti, inspektime të plota e të orientuara të shkollave publike e jopublike dhe DAR/ZA-ve, të kurrikulës dhe të Olimpiadave. Kjo veprimtari ka përfshirë funksionet e inspektimit që mbulon ISHA, të tilla si: vlerësimi i cilësisë në arsim, këshillimi, informimi dhe kontrolli i pajtueshmërisë me aktet ligjore dhe nënligjore.

Në bazë të këtij plani janë kryer tre inspektime të plota në: një shkollë 9-vjeçare dhe dy të mesme, duke u përqendruar kryesisht në fusha si menaxhimi i shkollës, kurrikula e zbatuar dhe mësimdhënia e të nxënësve. Në përfundim të këtyre inspektimeve u vërejtën mangësi të tilla si: mësimi zhvillohet kryesisht sipas metodës me në qendër mësuesin, përdorimi i paktë i mjeteve didaktike dhe laboratorit virtual gjatë procesit mësimor, nuk ka laboratorë të mirëfilltë për lëndët biologji e kimi; një shkollë të mesme profesionale në DAR Shkodër ku është konstatuar se shkolla ka mjedise pune efçente por baza prodhuese nuk e mbështet plotësisht veprimtarinë praktike të nxënësve dhe siguria në këto ambiente nuk është në përputhje të plotë me masat e sigurimit teknik; institucion arsimor parashkollor (kopësht) në Kavajë ku u vërejtën mangësi në shërbimin e psikologut për kopshtin.

Janë kryer 48 inspektime tematike në shkolla 9-vjeçare e gjimnaze dhe 96 kopshte publike, në drejtim të mësimdhënies e të nxënësve dhe sigurisë shëndetit dhe mjedisit fizik e psiko-social të nxënësve, ku në të gjitha janë vërejtur probleme të lagështisë, tavane në rrezik shembje, probleme me kanalizimet e ujërave dhe furnizimit me ujë të rrjedhshëm, mungesë të këndeve sportive, gjelbërimit, pajisje të klasave të amortizuara, mungesë të klasave laboratorike, gjendja fizike e tualeteve jashtë çdo standardi higjienik, ngrohje e pamjaftueshme, rrjete elektrike të shkollave të amortizuara që nuk përballon ngarkesën. Për këto janë lënë rekomandime për intensifikimin e bashkëpunimit me qeverisjen lokale, si dhe në kopshte nuk ka infrastrukturë të domosdoshme për fëmijët me aftësi të kufizuar.



Janë zhvilluar inspektime të orientuara për procedurat e rekrutimit në 27 Institucione arsimore jopublike, me qëllim vlerësimin e funksionimit të tyre në përputhje me aktet ligjore, ku u vërejtën mangësi në plotësimin e dokumentacionit të rekrutimit të mësuesve dhe dosjeve të tyre, kontratave të punës, në planet mësimore për kurrikulën bërthamë, ngarkesën mësimore të mësuesve, dokumentacionin shkollor për të cilat u lanë rekomandimet përkatëse për ndreqjen e tyre; 13 inspektime të orientuara për gjendjen dhe funksionimin e laboratorëve të informatikës dhe të atyre shkencorë ku u konstatua se të gjitha shkollat kanë laboratorë të informatikës por nuk u ofrojnë mundësi nxënësve t'i përdorin ato pas orës së mësimi, një pjesë ë madhe e shkollave nuk ka klasa laboratorike për lëndët e fizikës, biologjisë dhe kimisë, si dhe nuk kanë reagente kimike; 7 inspektime të orientuara për konsultimet e nxënësve të klasës IX dhe XII.

ISHA ka zhvilluar inspektime të orientuara për identifikimin e kopshteve jopublike të pa licencuara në DAR-in Tiranë, ku identifikuan 110 subjekte të tilla me 1452 fëmijë në mjediset e shtëpive private dhe në grupe të përziera, nuk u gjetën programe mësimore, nuk respektohen kërkesat dhe kriteret e dokumentacionit zyrtar. U dhanë rekomandime për mbylljen e aktivitetit mësimor që ofrojnë kopshtet pa licencë me kushte të papërshtatshme.

Nga monitorimet e kryera për procesin e provimeve të Maturës Shtetërore dhe provimeve të lirimit përgjithësisht, rezulton se është kryer në përputhje me rregulloren në fuqi, por ka patur dhe probleme të cilat duhen përmirësuar, si krijimi i kushteve të favorshme në mjediset e provimit, procesi i informimit të nxënësve për rregulloren e zhvillimit të provimeve, kopje nga nxënësit që ka çuar në përjashtimin nga provimi dhe zëvendësimi i administratorëve me ata rezervë.

Në kuadër të Alerteve të Alerteve janë monitoruar 24 shkolla të mesme dhe 41 shkolla 9-vjeçare për procedurën e përzgjedhjes së teksteve shkollore, ku është gjetur dokumentacioni i plotë.

Janë kryer inspektime të orientuara (17 ankime) në DAR/ZA dhe shkolla, në lidhje me emërimet dhe lëvizjet e personelit, marrëdhëniet mësues-nxënës e drejtori e shkollës me stafin e mësuesve, mjediset fizike të shkollës, për të cilat janë lënë rekomandimet përkatëse si zëvendësim i mësuesve dhe drejtorëve pa arsim përkatës, planifikim i saktë i ngarkesës mësimore, përmirësim i mjedisve fizike dhe i komunikimit.

6) Ministria e Kulturës

Inspektimet në këtë ministri përmbushen nga Drejtoria e Auditit të brendshëm e cila funksionon mbi bazë të ligjit nr. 9720, datë 23.04.2007 "Për auditimin e brendshëm në sektorin publik", i ndryshuar. Pra inspektimet nuk kryhen nga trupa të mirëfillta inspektuese, por së bashku me auditime. Gjatë vitit 2013 kjo drejtori e ka bazuar veprimtarinë e vet në planin strategjik të Auditimit dhe atë vjetor të vitit 2013, me drejtime kryesore kontrollin e përputhshmërisë së veprimtarisë së subjekteve me procedurat, ligjet dhe rregulloret e miratuara dhe marrjen e masave për përmirësimin e veprimtarisë.

Ishte planifikuar të kryeshin auditime (nuk janë inspektime) në 30 subjekte, përkatësisht inspektime të plota 19 subjekte me mbi dy vjet pa u inspektuar, 11 inspektime për të verifikuar përmbushjen e rekomandimeve. Nga këto 15 inspektime kanë përfunduar.


7) Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë

Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore vepron në bazë të ligjit nr. 10237, datë 18.2.2010 “Për sigurinë e shëndetit në punë” dhe ka 12 degë rajonale sipas qarqeve me 113 inspektorë gjithsej, me një mesatare 923 subjekte inspektimi për çdo inspektor. ISHPSHSH është përgjegjës për inspektimin e strukturave të shërbimit social rezidencial, jo rezidencial, publik dhe privat për respektimin e standardeve ligjore të miratuara.

Gjatë vitit 2013 ISHPSHSH ka përqendruar punën e vet në ngritjes së kapaciteteve të inspektorëve të punës, përmirësimi i procesit të inspektimit sipas parimeve të ligjit të ri për inspektimin dhe bërja e tij sa më eficient sipas standardeve në të gjitha drejtoritë rajonale, implementimi i praktikave të reja në inspektim, përcaktimi i prioriteteve të kontrollit, parandalimi për vendeve pune të sigurt, rritja e bashkëpunimit ndërinstytucional me qëllim shkëmbim informacioni dhe realizim inspektimesh të përbashkëta.

Ky Inspektorat është përfshirë në tre Inspektoratet pilot që ka realizuar gjatë vitit 2013 hartimin e dokumenteve standard të inspektimit në përputhje me kërkesat e ligjit për inspektimin dhe i ka hedhur ato në portalin e-inspektimit dhe pritet që në ditët në vijim të fillojë të kryejë procedurën standarde të inspektimeve dhe hedhjen e gjetjeve të inspektimit në kohë reale.

Gjatë vitit 2013, janë kryer gjithsej 14507 inspektime, ku 94.6 % kanë qenë të planifikuara, nga të cilat 14 427 (99.5%) janë inspektime në subjekte private. Inspektimet janë kryer sipas fushave: të zakonshme 13727, tematike 326 ose 3.3%, për aksidente në punë 89, për nxitje punësimi 133 dhe për shkak ankese 75 dhe për punën në turnet e II e III,e ditët e pushimeve 157. Nga këto 35% janë subjekte të inspektuara për herë të parë. Janë kryer 16 inspektime të përbashkëta.



Gjithsej punëmarrës të evidentuar në sektorin privat janë 163238, me një mesatare 11.3 punëmarrës/subjekt. Gjatë inspektimeve ka rezultuar se punëmarrës pa kontratë pune individuale janë 5426 ose 3.4%, nga të cilët 15.5% janë evidentuar në subjekte private të inspektuara për herë të parë dhe 4.7% në subjekte private të inspektuara jo për herë të parë.

Nga inspektimet është vërejtur se punëmarrës të pa deklaruar në Zyrat e Punës janë 1031 punëmarrës informal në subjektet private të inspektuara. Punëmarrës të pasiguruar janë 1434 ose 1.1% e punëmarrësve. Rezultojnë 41 të huaj pa leje pune nga 1003 gjithsej.

Gjatë inspektimeve janë evidentuar edhe problematika që kanë të bëjnë me pagesat e kontributeve të sigurimeve shoqërore mbi pagë minimale, kohëzgjatja javore e punës, pagesa e pushimeve vjetore, ndërprerja e marrëdhënieve të punës, punëmarrës me kohë të pjesshme, punësimi i fëmijëve, subjekte që punojnë me substanca të rrezikshme, sëmundjet profesionale të punëmarrësve, shërbimi mjek ndërmarrje.

Punëmarrës nën 18 vjeç janë gjithsej 122, përkatësisht në fasone dhe përpunim peshku.

Gjatë viti 2013 për shkeljet e konstatuara janë sanksionuar 99 subjekte me gjoba, që përfshin vetëm 0.7% të subjekteve të inspektuara, me vlerë 30 747 000 lekë, kryesisht në tregti dhe ndërtim.

Lidhur me aksidentet në punë, gjatë vitit 2013 në të gjitha llojet e aktiviteteve janë regjistruar 89 të aksidentuar në punë, nga të cilët 19 kanë përfunduar me humbjen e jetës. Sektorët më të prekur nga aksidentet janë ai i minierave, ndërmarrjeve prodhuese, elektricitet, gaz, ujë, ndërtimi, shërbime.

Për vitin 2014 ISHPSHSH do të vazhdojë procesin e ndërgjegjësimit të popullatës për rëndësinë e inspektimit të marrëdhënieve të punës, identifikimin e praktikave të mira për sigurinë e shëndetit në punë, promovimi i një kulture parandaluese, realizimi i inspektimeve të përbashkëta, për implementimin dhe zbatimin e standardeve, nëpërmjet përmirësimit të procesit të inspektimit.

8) Ministria e Shëndetësisë

Inspektorati Sanitar Shtetëror ushtron veprimtarinë e tij bazuar në ligjin nr. 7643, datë 2.12.1992 “Për Inspektoratin Sanitar Shtetëror” i ndryshuar. ISSH është organ ekzekutiv i specializuar, që kontrollon zbatimin e ligjeve e të akteve nënligjore sanitare në sektorët shtetërorë dhe privatë. Gjatë vitit 2013 ka zhvilluar aktivitetin e vet sipas planit vjetor dhe në përmbushje të misionit për ruajtjen e normave optimale të shëndetit publik. Puna është përqendruar në përmirësimin e vazhdueshëm të indikatorëve shëndetësorë dhe të performancës së saj, duke zhvilluar aktivitete të koordinuara të shërbimeve dhe sektorëve, në përmbushje të prioritetëve dhe objektivave kryesore si: monitorimi i vazhdueshëm i indikatorëve të higjienës mjedisore si ajri, uji, toka, higjiena komunale e siguria ushqimore; promovimi i shëndetit dhe marrja e masave parandaluese për sëmundjet e ndryshme.

Fusha e inspektimit të higjienës përfshin atë ushqimore, komunale, të punës dhe ajo shkollore dhe fëmijërore. Gjatë vitit 2013 janë mbajtur 30960 proces verbale, janë dhënë 3704 akt – miratimi higjieno sanitare dhe 124 akt–miratimi për sheshe ndërtimi.

Për sa i takon higjienës ushqimore në të gjithë vendin janë ushtruar inspektime higjeno-sanitare në njësitë e prodhimit, ruajtjes dhe transportit e tregtimit të produkteve ushqimore; për tregtim alkooli dhe njëkohësisht në rregullat për duhanin, duke bashkëpunuar me AKU dhe janë përfshirë në inspektime pjesa më e madhe e subjekteve (pa metodologji risku të mirëfilltë) ku janë marrë afërsisht 195357 mostra dhe janë kryer 126855 analiza kimike dhe 68502 analiza mikrobiologjike. Për sasinë e produkteve ushqimore që rezultuan jashtë standarteve janë zbatuar procedurat e asgjësimit duke marrë edhe masa administrative për personat përgjegjës. Po kështu janë marrë dhe analizuar 2249 mostra kripe për përmbajtjen e jodit, që në përgjithësi kanë qenë brenda parametrave të kërkuar.

Për sa i takon higjienës komunale janë marrë 119167 mostra uji si në depot e ujësellsave edhe në pikat fundore, ku për shkelje të konstatuara janë lënë detyrat përkatëse. Po kështu është mbajtur nën kontroll edhe situata për pastrimin e të gjitha qyteteve. Në lidhje me higjienën e ambientit janë vërejtur probleme serioze dhe të akumuluar të ndotjes së ambientit me mbeturina urbane. Janë kryer rreth 18227 matje të treguesve të ajrit (kryesisht në Tiranë).

Për sa i takon higjienës në punë është bërë evidentimi i ndotësve në ambiente, monitorimi i kushteve higjeno-sanitare të punës, pajisja me dokumentacion sanitar ku janë lëshuar gjithsej 32060 libreza shëndetësore.

Për sa i takon higjienës shkollore janë ushtruar inspektime higjeno sanitare në pjesën më të madhe të objekteve shkollore për kushtet higjeno-sanitare, dieta ushqimore dhe cilësinë e ushqimit, pajisja me libreza shëndetësore, ku është vënë re problem i numrit të rritur të nxënësve në klasa që ngarkon mikroklimën e këtyre ambienteve, si dhe nevoja për rikonstruksione dhe mjedise të gjelbëruara.

Për të gjithë aktivitetin e zhvilluar për shkeljet e konstatuara janë marrë 3142 vendime për mbyllje provizore të aktivitetit dhe 80 vendime për vendosje gjore.


Fusha e inspektimit të epidemiologjisë ka përfshirë mbajtjen nën kontroll të përhapjes së sëmundjeve dhe është bërë në kohë vaksinimi i popullatës, janë shpërndarë postera njohëse e sensibilizuese për sëmundje infektive dhe janë zhvilluar shumë biseda e seminare mbi këto tema në institucione shkollore dhe shëndetësore.

9) Ministria e Energjisë dhe Industrisë

Nuk ka paraqitur raport vjetor për vitin 2013. I kërkohet të përmbushë detyrimin ligjor të raportimit të INSQ, sipas ligjit të inspektimit dhe VKM përkatëse.

10) Ministria e Mjedisit

Inspektorati Shtetëror i Mjedisit gjatë vitit 2013 Inspektorati Shtetëror i Mjedisit ka kryer gjithsej 5850 inspektime, sipas fushave të inspektimit që mbulon: në mbetje urbane dhe ujërat e zeza 993, subjekte industriale 3616, inertet lumore për shfrytëzim të paligjshëm dhe moszbatim të kushteve të lejes mjedisore të subjekteve 214, spitalore 365, ndotjet akustike 174.



Pas inspektimeve të kryera për këtë vit janë vendosur 127 gjoba me vlerë 51 410 000 lekë dhe 64 pezullime aktiviteteve.

11) Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave

Nuk ka paraqitur raport vjetor për vitin 2013. I kërkohet të përmbushë detyrimin ligjor të raportimit të INSQ, sipas ligjit të inspektimit dhe VKM përkatëse.

12) KOMENTE

Gjatë përgatitjes së këtij raporti vjetor u vërejt se në fund të vitit 2013, megjithëse është miratuar ligji 10433, datë 16.06.2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, në përgjithësi trupat inspektuese të ministrive të linjës nuk arritën të implementonin parimet e përgjithshme dhe procedurat e reja të këtij ligji.

Në përgjithësi vihet re se trupat inspektuese të ministrive të linjës nuk kanë programim për sa i takon vizitave inspektuese te subjekteve që ato mbulojnë, pra nuk kryhet procesi i planifikimit vjetor e mujor në bazë të metodologjisë së vlerësimit të riskut. Raportet nuk paraqiten sipas një formati të caktuar të unifikuar për të gjitha inspektoratet shtetërore. Nga raportimi i tyre shihet se trupat inspektuese të ministrive të linjës nuk kanë standarde të njëjta, por veprojnë dhe raportojnë sipas praktikave tradicionale të inspektimit.

Vlen të theksohet s,e përveç Inspektorateve shtetërore të sipërpërmendur të cilët nuk kanë paraqitur raportin vjetor të veprimtarisë së tyre inspektuese për vitin 2013, ka edhe raste si Inspektorati Sanitar Shtetëror i cili ka raportuar jashtë kritereve minimale të raportimit.

Nga raportimi i tyre nuk del qartë procedura që ato ndjekin për sa i takon ankimit dhe apelimit. Inspektoratet shtetërore nuk kanë dhënë informacione të qarta në lidhje me buxhetet e tyre, gjobat dhe mënyra e masa e mbledhjes së tyre.

Nga shqyrtimi i raporteve dhe inspektimet e kryera pranë degëve rajonale të dy inspektorateve del se ato kryejnë edhe aktivitete të tjera përveç atyre të inspektimit. Pra inspektimet nuk kryhen nga trupa të mirëfillta inspektuese.

Konstatohet se, me gjithë përpjekjet e bëra për rritjen e kapaciteteve të inspektorëve, këta të fundit nuk janë trajnuar sipas parimeve të ligjit të ri të inspektimit dhe nuk janë pajisur me certifikatë dhe kartën e inspektorit.

13) PRAKTIKAT E MIRA

Gjatë shqyrtimit të raporteve vjetore të paraqitura nga Inspektoratet shtetërore, në praktikat e mira mund të përmendet:

- Bashkëpunimi, në shumë raste i frytshëm, ndërmjet ISHPSHSH dhe AKU, Inspektoratit të Mjedisit dhe IQT, për takimet, procedurat dhe inspektimet e përbashkëta të kryera nga këto inspektorate.
- Përpjekje e bërë nga ISHPSHSH dhe IQT për këshillime dhe masat parandaluese për shmangien e rreziqeve në punë, gjë e cila është edhe një nga risitë e ligjit të ri të inspektimit, pra funksioni parandalues i inspektimit.

14) REKOMANDIME

Mbi bazën e analizës së kryer mbi aktivitetin e Inspektorateve Shtetërore për vitin 2013 dhe plotësimet ligjore e strukturore që priten të plotësohen në vazhdim, rekomandohet si më poshtë:

- a) Të përfundojë riorganizimi i Inspektorateve shtetërore dhe të hartohen deklarata të qarta që përshkuan misionin e secilës prej tyre, i cili duhet të fokusohet në objektivat për mbrojtjen e interesit publik sipas fushave që ato mbulojnë, si dhe përmirësimin e klimës së biznesit.
- b) Të zhvillohen indikatorët e performancës për të gjithë Inspektoratet shtetërore që nga viti 2014 e në vazhdim, në bashkëpunim me komunitetin shkencor/profesional të fushës së tyre të inspektimit dhe bazuar në praktikatat më të mira kombëtare e ndërkombëtare.
- c) Ndjekja e parimeve të përgjithshme dhe procedurave të inspektimit sipas ligjit nr. 10433, datë 16.06.2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”. Rekomandohet të fillojë të zbatohet ky ligj për sa i takon procedurave unike të inspektimit, programimi i inspektimeve sipas metodologjisë së riskut dhe hartimit të dokumentacionit sipas metodologjisë unike, të miratohet VKM për rregullat e përgjithshme, bazë e vlerësimit të riskut dhe programimit të inspektimeve.¹²
- d) Legjislacioni themelor dhe rregulloret e çdo inspektorati shtetëror duhet të jenë koherente dhe të evidentohen ndryshimet e bëra çdo vit në këtë drejtim. Përafrimi i legjislacionit të fushave të ndryshme të inspektimit për sigurinë publike me *acqui communautaire*.
- e) Organizimi i inspektimeve të përbashkëta nga ana e Inspektorateve shtetërore, nën koordinimin e Inspektoratit Qendror, për të zvogëluar barrën ndaj bizneseve dhe mbajtja e raporteve të përbashkëta nga këto inspektime. Të zgjerohet fokusi i ndërveprimit e të përfshijë kontrollet të përbashkëta të zhvilluara me mbështetjen e sistemit për këshillimin dhe parandalimin.
- f) Inspektoratet shtetërore duhet të hartojnë një plan efikas biznesi për të siguruar një impakt sa më maksimal me burime të kufizuara që kanë në dispozicion. Hartimi i buxheteve realiste dhe transparente për të mbështetur punën e këtyre inspektorateve .
- g) Inspektoratet shtetërore duhet të hartojnë statistika të sakta dhe përmbledhëse, për të mundësuar analiza të qëndrueshme për të bërë përmirësime e dhura.
- h) T’i kushtohet kujdes kryerjes e raportimit të trajnimeve profesionale dhe të krijohet një set mjetesh dhe parametrat për vlerësimin e performancës. Inspektoratit Qendror të hartojë një manual trajnimi (udhëzues) dhe të kryejë trajnimin dhe certifikimin e të gjithë inspektorëve, sipas përcaktimit ligjor.¹³
- i) Formate të standardizuara të raportimit, më mënyrë që të unifikohen raportet vjetore të inspektorateve shtetërore për të evidentuar në vazhdimësi veprimtarinë e tyre. Inspektorati Qendror të hartojë dhe miratojë formatin standard të raportimit.¹⁴
- j) Të ushtrohet kontroll efektiv mbi aktivitetin e inspektimeve për të rritur përgjegjshmërinë në punë të inspektorëve.
- k) Të hartohen dhe zbatohen procedura të qarta dhe të unifikuara të vjeljes së gjobave, sipas legjislacionit në fuqi, si dhe të pasqyrohen ato në portalin e-inspection.
- l) Të evidentohen partnerët e huaj të Inspektorateve shtetërore dhe forcohen marrëdhëniet me ta për marrjen e eksperiencave dhe praktikave të mira.

¹² Neni 16, pika c, e ligjit nr. 10433, datë 16.06.2011 “Për inspektimin në RSH”.

¹³ Neni 16, pika ë, po aty.

¹⁴ Neni 16, pika e, po aty.

- m) Vënia nga inspektoratet shtetërore e Linjës telefonike për bizneset dhe qytetarët në lidhje me ankesat dhe pasqyrimi i tyre në portal.
- n) Ëëbsite të përditësuara të Inspektorateve shtetërore, të publikojnë broshurë për subjektet me procedurat dhe informacione të tjera përkatëse. Informimi i publikut duhet të rritet më tej në mënyrë që bizneset që operojnë në Shqipëri të njohin të drejtat dhe detyrat e tyre.
- o) Të përmirësohet kultura e komunikimit me rrjetet informative dhe të komunikimit për të rritur transparencën dhe ndërgjegjësimin e publikut. Informacioni në lidhje me aktivitetet e inspektorateve duhet të jenë në dispozicion të publikut
- p) Të bëhet promovimi i portalit unik e-inspection te bizneset dhe publiku i gjerë, të bëhet promovimi i Inspektoratit Qendror me postera dhe fletëpalosje.

15) KONKLUZIONE

Synimet e reformës do të përmbushen nëpërmjet arritjes së të gjitha objektivave të analizuara më sipër. Për këtë nevojitet bashkëpunim i Inspektoratit Qendror me Inspektoratet shtetërore dhe këto të fundit ndërmjet tyre. Për këtë arsye duhet të sigurohen takime midis drejtuesve të këtyre institucioneve në çdo 6 muaj për të bashkërenduar aktivitetin e institucioneve të tyre, me koordinimin e kryer nga Inspektoratit Qendror.

Pavarësisht përpjekjeve të bëra për zbatimin e ligjit të inspektimit, nuk ka ende unifikim të procedurave të inspektimit ndërmjet të gjitha Inspektorateve shtetërore për sa i takon programimit, vlerësimin të riskut, vlerësimin mbi bazë performance. Kapacitetet njerëzore janë të dobëta, kjo është një nga arsyet e mosfunksionimit të plotë të ligjit të inspektimit, prandaj është e domosdoshme hartimi dhe zbatimi i procedurave të trajnimit dhe certifikimit të inspektorëve.

Publikimi i emrave të inspektorëve në detyrë dhe pajisja e tyre me kartën e inspektorit. Inspektorati Qendror duhet të konsultojë dhe miratojë kodin e etikës së inspektorit, të përditësojë emrat online të të gjithë inspektorëve të cilët kanë të drejtën e kryerjes së procedurave të inspektimit për konsolidimin e Regjistrisë Kombëtare të Inspektorëve, sipas përcaktimit ligjor dhe të miratohet me VKM karta e inspektorit¹⁵.

Sfida është kompletimi i paketës së akteve nënligjore në zbatim të ligjit të inspektimit¹⁶ dhe zbatimi i tyre, si dhe hedhja e të dhënave të Inspektorateve shtetërore në portalin e-inspektimi për bërjen e tij funksional.

Inspektorati Qendror duhet të rrisë rolin e vet mbikëqyrës dhe koordinues te veprimtarive të inspektimit. Duke parë ecurinë e zbatimit të reformës së inspektimit të hartohet dhe miratohet strategjia e Inspektoratit Qendror me plan veprimi me afate konkrete për realizimin e tyre. (Kjo duhet konsultuar me Inspektorin e Përgjithshëm. Nëse ai është dakord mund të japim edhe një përshkrim të shkurtër të kësaj strategjie)

¹⁵ Neni 16, pika h, e ligjit 10433, datë 16.06.2011 “Për inspektimin në RSH”.

¹⁶ Tabela me draft aktet nënligjore për miratim është Aneksi nr. III

ANEKSI I : Akte nënligjore të miratuara

Nr.	Baza ligjore (Ligji për Inspektimet)	Emërtimi i akteve nënligjore	Data e miratimit
1.	Pika 3, neni 12	VKM për kriteret dhe procedurat e përzgjedhjes, emërimit, vlerësimit të rezultateve në punës, disiplinës dhe lirimit nga detyra të kryeinspektorit	VKM 373, 16 Maj 2012
2.	Pika 2, neni 15	VKM nr. 630, 14.09.2011, “Për organizimin dhe funksionimin e Inspektoratit Qendror”	VKM nr. 630, datë 14 Shtator 2011
3.	Pika, 5 neni 16	VKM “Për përcaktimin e procedurave të ushtrimit të kompetencave të inspektoratit qendror dhe të rregullave për përmbajtjen dhe administrimin e portalit unik “e-inspektimi”	VKM nr. 696, datë 16.8.2013
4.	Pika 3, neni 15	Urdhër për strukturën dhe organikën e Inspektoratit Qendror	Urdhri nr. 5, datë 31 Janar 2013
5.		Rregullore e brendshme e Inspektoratit Qendror	Urdhër nr. 18, datë 24.09.2012
6.		Rregullore për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike në Inspektoratin Qendror	Urdhër nr. 7, datë 20.09.2012

ANEKSI II: VKM për krijimin e Inspektorateve shtetërore

Nr.	Baza ligjore (Ligji për Inspektimet)	Emërtimi i akteve nënligjore	Data e miratimit
1.	Pika 2, neni 11	VKM për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Inspektoratit Shtetëror të Arsimit	VKM nr. 352, 3 Prill 2013
2.	Pika 3, neni 11	Urdhër për miratimin e strukturës dhe -organikës së Inspektoratit Shtetëror të Arsimit	
3.	Pika 2, neni 11	VKM për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Inspektoratit Shtetëror të Punës	VKM nr. 295, 20 Mars 2013
4.	Pika 3, neni 11	Urdhër për miratimin e strukturës dhe organikës së Inspektoratit Shtetëror të Punës	
5.	Pika 2, neni 11	VKM për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Inspektoratit Shtetëror Shëndetësor	VKM nr. 241, 27 Mars 2013
6.	Pika 3, neni 11	Urdhër për miratimin e strukturës dhe organikës së Inspektoratit Shtetëror Shëndetësor	
7.	Pika 2, neni 11	VKM për amendimin e VKM për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Autoritetit Kombëtor të Ushqimit	VKM nr. 257, 6 Mars 2013
8.	Pika 3, neni 11	Urdhër për miratimin e strukturës dhe organikës së Autoritetit Kombëtor të Ushqimit	
9.	Pika 2, neni 11	VKM për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Inspektoratit Shtetëror të Mjedisit, Pyjeve, Ujrave dhe Peshkimit	VKM nr. 223, 13 Mars 2013
10.	Pika 3, neni 11	Urdhër për miratimin e strukturës dhe organikës së Inspektoratit Shtetëror të Mjedisit, Pyjeve, Ujrave dhe Peshkimit	
11.	Shkronja f), pika 2, neni 16	Kërkesa specifike për arsimimin inspektorëve në inspektoratet shtetërore dhe vendore	

ANEKSI III: Draft akte nënligjore për miratim

Nr.	Baza ligjore (Ligji për Inspektimet)	Emërtimi i akteve nënligjore	Data e pritëshme e miratimit
1	Shkronja c), pika 2, neni 16	Rregulla të përgjithshme bazë për metodologjinë e vlerësimit të riskut	Brenda vitit
2	Shkronja c), pika 2, neni 16	Programimi i inspektimeve	
3	Shkronja c), pika 2, neni 16	Dokumentimi i inspektimeve	
4	Shkronja c), pika 2, neni 16	Raportimi i veprimtarisë së inspektorateve	
5	Shkronja ç), pika 2, neni 16	Rregulla të përgjithshme për treguesit e përgjithshëm të efektivitetit dhe të cilësisë së veprimtarisë së inspektimit, & Krite për vlerësimin e treguesve e rregullave të përgjithshme të efektivitetit dhe të cilësisë së veprimtarisë së inspektimit	
6	Pika 3, neni 21	VKM për intervalet e testimit periodik, rregullat e hollësishe për procedurën e provimit dhe kriteret përkatëse të vlerësimit në këtë procedurë	Brenda vitit
7	Pika 7, neni 48	VKM për rregulloren e përgjithshme të metodologjisë së përcaktimit të dënimeve administrative, në përputhje me parimin e proporcionalitetit	Brenda vitit
8	Pika 3, neni 51	VKM për Organizimi i organit epror për çdo inspektorat shtetëror	Brenda vitit
9		Kodi etik i inspektorëve shtetërorë, si dhe një guidë mbi të drejtat dhe detyrimet e tyre	
10	Pika 2, neni 26	VKM për përcaktimin e periudhës maksimale të lejuar të inspektimeve vjetore, në varësi të madhësisë së subjektit dhe rrezikut të veprimtarisë.	Brenda vitit
11	Pika 7, neni 38	VKM për procedurat për marrjen dhe trajtimin e mostrave sipas tipit të inspektimit si dhe metodologjia e llogaritjes së shpenzimeve.	Brenda vitit
12	Pika 1 vkm ë	VKM Rregullore për përdorimin e portalit “e-Inspektimi” .	30.05.2014
13	Pika 4 neni 30	Miratimi i kartës se inspektorit	30.04.2014